



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2024:229559

Datë: 01.11.2024

Numri i dokumentit: 06383977

P.nr.234/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni në çështjen penale kundër të pandehurit B.M. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprave penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1358/24 të datës 28.08.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar e publik me datën 22.10.2024, në praninë e prokurores së shtetit Vyrtyte Gërvalla, të pandehurit B.M. dhe mbrojtësit sipas detyrës zyrtare av.Irfan Zushi, pas shpalljes së aktgjykimit me datë 22.10.2024, ndërsa me datë 28.10.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: B.M., nga i ati N., e ëma S., e vajzërisë H., data e lindjes... në fshatin M., komuna e Vushtrrisë, ku edhe jeton, me numër personal ..., punon si shofer në kompaninë e shpedicionit “Star Shped”, i martuar, prind i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

I. SEPSE: Me datë 07.08.2024, rreth orës 18:00 minuta, në fshatin Maxhunaj, komuna e Vushtrrisë, saktësisht në shtëpinë e tij, me dashje e në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-022 për Armë, e përdor armën e zjarrit te llojit M57 me numër serik M-144738 duke shtënë në ajër dy here me të, në atë mënyrë që: përderisa i pandehuri ishte në një aheng familjar merr armen e lartcekur dhe me te gjuan dy here në ajër, me ç’ rast zyrtarët policor sapo pranojnë informacionin për gjuajtje me arme, lokalizojnë vendin ku është përdor arma, ku edhe gjejnë 2 gëzhoja të armës se lartcekur, të cilat sekuestrohen bashke me armën tjerët të llojit Zoraki M900-B e kalibrit 7.62mm P.A.K, e te cilën armë i pandehuri ia dorëzon policisë se kinse është arma që është përdorur natën kritike, ku pas krahasimit të gëzhojave me armen në fjalë të njëjtat nuk përputhen mes vete, pasi që rezulton se ato gëzhoja janë të armës së sipërshënuar të llojit M57 me numër serik M-144738,

- Me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

II. SEPSE: Nga koha e panjohur e gjerë më datë 07.08.2024 në fshatin Maxhunaj, komuna e Vushtrrisë me dashje e në kundërshtim me nenin 5 par.1, nenin 17 par.1 nënpar.1.1, nenin 18 par.1 nënpar.1.2 e lidhur me nenin 7 të Ligjit Nr.05/L-022 për Armë, mban në posedim armë, në atë mënyrë pasi policia njoftohet lidhur me gjuajtjen me armë si në pikën I të dispozitivit, i pandehuri e dorëzon fillimisht armen e llojit Zoraki M900-B e kalibrit 7.62mm P.A.K se bashku me një karikator të kësaj arme, ndërsa gjatë intervistimit njofton policinë se arma me te cilën është shkrepë si në pikën I të dispozitivit është armë M57 me numër serik M-144738, të cilën së bashku me karikatorin e asaj arme e dorëzon në polici, e për të cilat armë si me larte nuk posedonte leje përkatëse, ashtu që të njëjtat se bashku me dy gëzhhojat dhe 2 fishekët sekuestrohen nga policia,

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72, 366 par.1 dhe 367 par.1 të KPRK-së dhe nenit 241, 242, 364 dhe 449 të KPPK-së, e

G J Y K O N

TË PANDEHURIT B.M.

I. Për veprën penale të përshkruar si ne pikën I të dispozitivit i shqipton DËNIM ME BURG, në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprën tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti.

II. Për veprën penale të përshkruar si ne pikën II të dispozitivit i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej gjashtëqind (600) euro i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri refuzon ose nuk mundet të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

URDHËROHET- Konfiskimi i përhershëm i armës së llojit M57 me numër serik M-144738 me një karikator, i armës se llojit Zoraki M900-B e kalibrit 7.62mm P.A.K me karikator dhe i 2 gëzhhojave dhe 2 fishekëve.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e arsytimit të aktgjyqimit

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.1358/24 të datës 28.08.2024, kundër të pandehurit B.M. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprave penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 dhe Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 22.10.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që: I pandehuri B.M. ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë, i premtton gjykatës që në të ardhmen kjo veprë nuk do të përsëritet më dhe në të njëjtën kohe i kërkon falje gjykatës.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri në raport me dy veprat penale, ndërsa me rastin e matjes se llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata të merr si rrethane lehtësuese pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, sjelljen e tij korrekte të treguar jo vetëm në gjykatë por edhe para prokurorit të shtetit, premtimin e tij se nuk do të përsëris me vepra penale, e me theks të veçantë gjykata të vlerësoj si rrethanë lehtësuese faktin se i pandehuri sipas ekstraktit mbi evidencat penale të lëshuar nga KGJK nuk është i dënuar asnjëherë për asnjë lloj të veprave penal, ndërsa si rrethanë rënduese të merr faktin se këto vepra penale paraqesin një rrezikshmëri shoqërore të lartë e që kjo ndërlidhet në mënyrë direkte me pasojat që mund të shkaktohen nga veprat e kësaj natyre, ndërsa rrethanë tjerë rënduese sipas prokurorit lidhur me këtë çështje penale nuk ka ndërse lidhur me konfiskimin ka deklaruar se mbetet pran propozimit të pikës V në aktakuzë.

Mbrojtësi i të pandehurit sipas detyrës zyrtare av.Irfan Zushi lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë, duke e bindur gjykatën se në të ardhmen i mbrojturi i tij nuk do të merr veprime të tilla negative që mund të shfaqin gabime negative tek shoqëria, ashtu që i propozon gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të mbrojturit të tij dhe të i shqiptoj një dënim më të butë duke i marr parasysh rrethanat lehtësuese si fakti se i mbrojturi i tij nuk ka ra ndesh me ligjin.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Gjykata, duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë është në pajtim me nenin 242 të KPPK-së, kjo pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza si: raporti fillestar i incidentit me

numër të rastit 2024-BD-741, i datës 07.08.2024, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin B.M., i datës 07.08.2024, vërtetimi mbi konfiskimin e armës, i datës 07.08.2024 dhe raporti i oficerit, i datës 07.08.2024, si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprat penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 367 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm “*Kushdo që përdorë armë apo materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.*”.

Ndërsa në nenin 366 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprave penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethanë posaçërisht lehtësuese e ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka ra ndesh me ligjin ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale dhe faktin se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese kjo gjykatë ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo vepër penale.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për zbutjen e dënimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit në pajtim me nenin 71 par 1 nën par 1.3 e lidhur me nenin 75 par 1 nën par 1.t të KPPK-së.

Arsyet lidhur me konfiskimin, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Urdhrin për konfiskimin e armës gjykata e ka marrë konform nenit 366 par.3 të KPRK-së ku është përcaktuar se “Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.234/2024, datë 01.11.2024

GJYQTARI

Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.